


Forcimi i inspektimit dhe Normave të Sigurisë Ushqimore në Shqipëri

MANUAL

Për Inspektimin Fitosanitar në Pikat e kalimit Kufitar



Ministria e Bujqësisë,
Ushqimit dhe Mbrotjes së Konsumatorit

**OBSH - Programi Kombëtar CARDS 2003 në Shqipëri
FORCIMI I INSPEKTIMIT KUFITAR VETERINAR DHE FITOSANITAR
NË SHQIPËRI**



MINISTRIA E BUJQESISE, USHQIMIT
DHE M BROJTJES SE KONSUMATORIT

**FORCIMI I INSPEKTIMIT DHE NORMAVE TË SIGURISË USHQIMORE
NË SHQIPËRI**

MANUAL

PËR INSPEKTIMIN FITOSANITAR NË PIKAT E KALIMIT KUFITAR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË
KONSUMATORIT

DFSUMK

Adresa: "Sheh Skënderbej", Nr.2 Tirane

Tel/Fax: + 355 4 259 333

Nr. 603 Prot
4635

Tiranë më: 16/10/2006
16/10/2006

MANUAL
PER INSPEKTIMIN FITOSANITAR NE PIKAT E KALIMIT KUFITAR.

Jemin GJANA
MINISTER

Drejtoria e Pergjithshme e Sigurie Usqyimore dhe Mbrotjes se Konsumatorit (DPSL MK)

PASQYRA E LËNDËS

HYRJE..... MANUAL I INSPEKTIMIT FITOSANITAR KARANTINOR

Qellimi
KONTROLI KARANTINOR.....

Inspektimi
Manifesti i anijes.....
Fatura e ngarkimit.....
Fatura e shitjes

Lista e ambalazheve.....

**KERKESA TE VEÇANTA PER LENDEN DRUSORE TE PERDORUR SI AMBALAZH
OSE NE PALETA**.....

Regullore mbi masat fitosanitare për tregëtimin e ambalazhit prej druri

Standarti - ISPM 15:

Kërkesat për ambalazhin prej druri të përdorur në produktet e importuara.....

Veprime ne perfundim te inspektimit

**PERCAKTIMI I RREZIKUT FITOSANITAR NE NJE NGARKESE
PROBLEME DHE VEPRIME QE NDERMERREN**.....
MENYRA E KRYERJES SE INSPEKTIMIT:

Teknika e kontrollit karantinor dhe nxjerra e mostrave nga materialet per mbjelleje

Madhesia e mostrave mesatare te disa farerave.....

Kontrolli karantinor dhe marrja e mostrave per tuberet e patates.....

Kontrolli fitosanitar dhe masat qe duhen marre:

Teknika e kontrollit karantinor dhe nxjerrjes se mostrave nga materiali shumezues dhe mbjel

Procedura per kontrollin fitosanitar fizik te materialit per mbjelleje:

Kontrolli karantinor dhe marrja e mostrave nga frutat dhe perimet per konsum.

Kontrolli fitosanitar dhe masat qe duhen marre:

Procedura e kontrollit fitosanitar

Mostrat per analiza laboratorike zyrtare pregatiten sipas kesaj menyre (psh. per frutat):.....
MOSTRA:.....

PREGATITJA:

IDENTIFIKIMI:.....

Flete shoqeruese, kerkese per analiza laboratorike per diagnostimin.....
e paraziteve te bimeve

Pjesa A

Pjesa B

**METODA E KRYERJES SE ANALIZES NE PIKEN E KONTROLLIT
KARANTINOR**.....

1. Analiza entomologjike.....
2. Analiza e nematodave.....
3. Analiza fitopatologjike per semundjet kerpuadhore.....
4. Analiza per semundjet bakteriale.....
5. Analiza per semundje virusale.....
6. Analiza per farerat e barerave te keqia.....

HYRJE

Ky manual është produkt i Projektit të OBSh-CARDS 2003 «Forcimi i Inspektimit Kufitar Veterinar dhe Fitosanitar në Shqipëri», financuar nga Komisioni Europian dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë në Shqipëri. Dokumenti është rezultati përfundimtar i punës së bërë nga ekspertët e siguruar nga OBSh, stafi i OBSh i lidhur me projektin dhe grupi i punës i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Manuali do tu shërbejë inspektorëve Fitosanitar në Pikat e Kalimit Kufitar si udhëzues në realizimin e detyrave të tyre teknike të inspektimit. Manuali shoqërohet nga urdhëri i Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për aprovimin e tij.

MANUAL I INSPEKTIMIT FITOSANITAR KARANTINOR

Qellimi

Qellimi i ketij manuali eshte te ndihmoje inspektoret e karantines fitosanitare ne kryerjen e kontolleve ne bime, produkte bimore dhe objekte te tjera, per parandalimin e hyrjes dhe perhapjes se paraziteve karantinore ne territorin e Republikes se Shqiperise.

Ky manual pajis me njojuri teknike inspektoret e karantines fitosanitare me qellim zbatimin e Ligjit “Per Sherbimin e Mbrojtjes se Bimeve” dhe Ligjit “Per Materialin Mbjelles Bimor”.

Ne kuptim te ketij manuali, me termat e meposhteme nenkuptohen:

“**Bime**” jane bime te gjalla ~~o~~ pjese te tyre po ashtu te gjalla, duke perfshire farerat dhe germoplazmen.

Pjeset e gjalla te bimeve perfshijne:

- *fruta* – ne kuptimin botanik, te ndryshme nga ato te konservuara me ane te ngrirjes se thelle;
- *perime*, te ndryshme nga ato te konservuara me ane te ngrirjes se thelle;
- *tubere, drithra, bulba, rizoma*;
- *lule te prera (buqeta)*;
- *dege me vegjetacion (gjethë)*;
- *peme te prera qe mbajne vegjetacion (gjethë)*
- *kultura indore te bimeve*;
- *polen i gjalle*;
- *sytha, copa, kalema*;
- *Farat*, duhet te konsiderohen fara ne kuptimin botanik, te ndryshme nga ato qe nuk mendohen per t'u mbjelle.

“**Bime qe mendohen te mbillen**” jane:

- bime tashme te mbjella dhe jane menduar te mbeten te mbjella, ose te rimbillen pas hyrjes se tyre, ose,
- bime qe nuk jane mbjelle ne kohen e hyrjes, por qe jane planifikuar te mbillen me pas.

“**Çertifikate fitosanitare**” eshte nje dokument zyrtar qe verteton gjendjen fitosanitare te nje ngarkese, e cila eshte subjekt i inspektimit fitosanitar.

“Hyrje” (ngarkese) eshte levizja permes nje pike hyrje kufitare per ne nje zone brenda vendit (Shqiperise).

“Infektim” eshte prania ne bime, produkte bimore ose objekte te tjera subjekt i inspektimit, i paraziteve te gjalle.

“Inspektim” eshte egzaminimi vizual zyrtar i bimeve, produkteve bimore ose objekteve te tjera subjekt i ketij manuali per te percaktuar nese ato jane te infektuar ose kontaminuar me parazite dhe te percaktoje nese ato jane ne konformitet me anekset e ketij manuali. Ky inspektim konsiston ne:

- kontrolle dokumentare;
- kontrolle identiteti;
- kontrolle fizike te shendetit te bimeve, produkteve bimore dhe objekteve te tjera qe inspektohen.

“Inspektor” eshte person i autorizuar nga Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit per te kryer funksione te caktuara ne zbatim te inspektimit fitosanitar karantinor.

“Karantine bimore” eshte- nje teresi veprimesh qe ka per qellim te parandaloje hyrjen dhe/ose perhapjen e nje paraziti karantinor ose te garantoje kontrollin zyrtar te ketij paraziti.

“Karantine” eshte- ndalese dhe izolim zyrtar i bimeve, produkteve bimore ose objekteve te tjera subjekt i ketij manuali per t'u vrojtuar, ekzaminuar, per inspektime te metejeshme, per prova dhe / ose trajtime.

“Kontaminim” eshte prania ne nje ngarkese, vend ruajtje ose mjet transporti e paraziteve ose objekteve te tjera subjekt i kesaj irregulloreje por qe nuk perbejne infektim.

“Kontroll dokumentar” eshte egzaminim visual zyrtar i dokumentave shoqeruese, certificates fitosanitare, me qellim qe te percaktohet nese ato jane plotesuar sic duhet dhe jane te vlefshem.

“Kontolle identitei” eshte egzaminim visual zyrtar i dokumentave dhe bimeve, produkteve bimore dhe objekteve te tjera te importuara per te percaktuar nese ato perputhen apo jo.

“Lot” eshte grapi ose teresia e elementeve te nje malli, i identifikuar nga nje homogenitet ne perberje, origine etj. (nje ose disa lote mund te perbejne nje ngarkese) (FAO, 1990).

“Mostër per identifikim nga eksperte” eshte e gjithe sasia ose pjese te bimeve, produkteve bimore ose objekteve te tjera qe bartin simptoma dhe /ose shenja qe bejne te mundur te supozohet per pranine e organizmave te demshem karantinore te pershkruar ne anekset, ose qe jane te panjohur dhe / ose organizma jo te

identifikuar present mbi bime produkte bimore dhe objekte te tjera, dhe qe preqatiten per t'u derguar ne laborator.

“Ngarkese” eshte nje sasi bimesh, produktesh bimore, dhe/ose objekte te tjera subjekt i ketij manuali, te cilat levizin nga nje shtet ne tjetrit dhe qe perfaquesohen nga nje Certifikate Fitosanitare e vetme (nje ngarkese mund te jete e perbere nga nje ose me shume lote).

“Njesi egzaminimi” eshte nje lot nese ngarkesa eshte e perbere nga dy ose me shume lote, dhe e gjithe ngarkesa nese ajo eshte e perbere vetem nga nje lot.

“Njesi inspektimi” eshte nje numer minimal individesh, te zgjedhur prej bimeve, produktive bimore ose objekteve te tjera duke perdorur nje metode te pershtateshme statistikore (psh. numur i rastesishem) qe pason identifikimin e nivelit te rrezikut per shendetin e bimes, me qellim per te formuar nje moster perfaquesuese te njesise qe do te egzaminohet.

“Objekte te tjera” eshte cdo vend ruajtje, mjet transporti, kontainer, toke, organizma te gjalla dhe cdo objekt tjeter, ose material qe eshte i pershatshem per strehimin ose perhapjen e paraziteve, vecanerisht ne transportin nderkombetar.

“Parazit karantinor” eshte nje parazit i rrezikshem, me rendesi ekonomike per vendin, qe nuk eshte verejtur ose eshte verejtur por nuk eshte i perhapur gjeresisht dhe luftohet ne menyre aktive.

“Parazit” jane demtuesit, semundjet ose barerat e keqia te demshme, ose potencialisht te demshme per bimet dhe produktet bimore.

“Pike kufitare hyrje” eshte aeroport, port detar ose pike hyrje kufitare tokesore e percaktuar zyrtarisht per hyrjen e bimeve, produktive bimore ose objekteve te tjera subjekt i kesaj rregulloreje.

“Produkt bimor” eshte send me origjine bimore i pa perpunuar (perfshire edhe drithrat) si dhe ato te perpunuarat te cilat, per vete natyren e tyre ose menyren e perpunimit, mund te jene rrezik per hyrjen dhe perhapjen e paraziteve.

“Prove” eshte ekzaminimi zyrtar, i ndryshem nga ai vizual, per te percaktuar nje parazit ose per te vertetuar pranine e tij ne nje ngarkese.

“Rieksport, (ngarkese e rieksportuar)” eshte nje ngarkese e cila eshte importuar ne nje shtet, nga i cili pastaj eksportohet pa u ekspozuar ndaj infektimeve ose kontaminimeve nga parazitet edhe nese ngarkesa ruhet, ndahet, kombinohet me ngarkesa te tjera ose i ndryshohet ambalazhi.

“Trajtim” eshte nje procedure zyrtare e autorizuar per ngordhjen, largimin ose berjen infertil te paraziteve.

Se b.
“Vend origjine”, (per objekte te tjera subjekt i ketij manuali) eshte vendi ku keto objekte jane ekspozuar per here te pare ndaj paraziteve dhe jane infektuar ose kontaminuar prej tyre.

“Vend origjine”, (per bimet) eshte vendi ku bimet jane kultivuar.

“Vend origjine”, (per produkte bimore), eshte vendi ku jane kultivuar bimet prej te cilave jane perftruar produktet bimore.

“Zone e mbrojtur” eshte zona te cilen Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit e ka percaktuar si zonen me te vogel per te realizuar nje mbrojtje efektive ndaj nje paraziti karantinor.

“Zone” eshte shtet, ose territor a pjese e shtetit e cila eshte e emertuar zyrtarisht (fshat, komune, rrith etj.).

KONTROLI KARANTINOR

Inspektimi

Importuesit (te cilet duhet te jene te rregjistruar sipas kerkesave qe do te pershkruhen me poshte) e bimeve, produkteve bimore, apo objekteve te tjera, ose agjente perfaquesues te tyre, jane te detyruar te njoftojne 48 ore para mbrditjes se ngarkeses ne pikun doganore te hyrjes, zyren e inspektimit fitosanitar te pikes kufitare te hyrjes, ose Drejtorine e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit (DBUMK) te qarkut ku do te hyje ngarkesa per: vendin e origjines, llojin, qellimin e perdonimit, destinacionin dhe specifikime te tjera qe mund t'i kerkohen. Importuesit duhet te dorezojne ne zyren e inspektimit fitosanitar karantinor te pikes kufitare te hyrjes, nje kerke me shkrim per inspektim fitosanitar te ngarkeses se tyre.

R. Endeksi *1*
Mbi bazen e dokumenteve qe paraqet importuesi, inspektori fitosanitar fillon kontrollin e dokumentave qe shoqeron ngarkesen.

Ne se gjate kontrollit dokumentar, inspektori konstaton se ngarkesa eshte e perbere nga bime, produkte bimore dhe objekte te tjera te permendura ne Aneksin III (te Rregullores mbi inspektimin karantinor fitosanitar), kur ato kane origjine nga shtetet e permendura ne ate Aneks; atehere ai nderpret inspektimin dhe ndermerr hapa te metejshme me qellim ndalimin e hyrjes se ngarkeses dhe rikthimin e saj ne vendin e origjines.

Gjithashtu, nese gjate kontrollit, inspektori konstaton parazitet e permendor ne Aneksin I (te Rregullores mbi Inspektimin karantinor fitosanitar), ndalon menjehere veprimet e metejshme dhe bashkepunon me organet doganore per kthimin e menjehershem te ngarkeses ne vend origjinjen e tyre.

Kur pas inspektimit fitosanitar ngarkesa me bime, produkte bimore dhe objekte te tjera rezulton e infektuar apo kontaminuar nga parazite te specifikuara ne Aneksin II, kesaj ngarkese i ndalohet hyrja ne territorin e Republikes se Shqiperise.

Nese inspektori vendos moslejimin e hyrjes se nje ngarkese, ai ploteson nje njoftim mbi identifikimin dhe kapjen e kesaj parregullsie dhe e dergon kete menjehere ne DBUMK, e cila nga ana e saj njofton strukturen e mbrojtjes se bimeve menjeherne ne Ministrine e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit.

Ndalesat e permendura me siper mund te mos aplikohen ne kushte te vecanta te cilat percaktohen nga Ministri, ne rastet e infeksioneve apo kontaminimeve te lehta me parazite te permendur ne Aneksin I dhe Aneksin II te bimeve apo produkteve bimore te cilat nuk jane te destinuara per t'u perdorur si material shumezues.

Ministri mund te ndaloje hyrjen dhe perhapjen ne territorin e Shqiperise te paraziteve te cilet nuk jane permendur ne Aneksin I dhe II; si dhe hyrjen dhe perhapjen ne territorin e Shqiperise te paraziteve te permendur ne Aneksin II, por te ndodhur ne bime e produkte bimore te pa permendura ne kete Aneks.

Ministri mund te lejoje futjen e paraziteve te permendur ne Anekset I dhe II kur ato nevoiten per qellime shkencore ose seleksionuese (punime shkencore, studime te rezistences varietore etj.).

Bimet, produktet bimore dhe objekte te tjera te percaktuara ne Aneksin IV, Seksioni 1, lejohen te hyjne ne territorin e Shqiperise, vetem pasi ato ti jene neneshtuar inspektimit fitosanitar dhe jane plotesuar kerkesat e vecanta te percaktuara ne kete seksion.

Sasi te vogla bimesh e produktesh bimore, te cilat parashikohen te perdoren nga zoteruesi ose pritesi i tyre per qellime jo industriale e jo tregetare, i neneshtrohen inspektimit fitosanitar kur inspektori e gjykon te arsyeshme dhe jane subjekt i ndalimeve apo kufizimeve kur jane te infektuara apo kontaminuara me parazite te permendur ne Anekset I dhe II.

Nje ngarkese me bime, produkte bimore ose objekte te tjera te percaktuara ne Aneksin V, Pjesa B, ose te pa percaktuara ne Aneksin V, Pjesa B por te paisura me Çertifikate Fitosanitare, lejohet te hyje ne territorin e Shqiperise, vetem ne se ato, ambalazhet dhe mjetet e transportit te tyre, jane inspektuar ne teresi ose nepermjet nje mostre perfaquesuese dhe eshte gjykuar se:

- Nuk ka infekcion apo kontaminim nga parazite te percaktuara ne Aneksin I ne ngarkesen me bime, produkte bimore dhe objekte te tjera te percaktuara ne Aneksin V, Pjesa B.
- Nuk ka infekcion ose kontaminim nga parazitet e permendur ne Aneksin II ne bimet ose produktet bimore te perfshira ne kete Aneks.
- Jane plotesuar kerkesat specifike te percaktuara ne Aneksin IV, Seksioni 1 per bimet, produktet bimore dhe objektet e tjera te permendura ne kete Aneks.
- Kur bimet, produktet bimore dhe objektet e tjera te importuara jane te percaktuara ne Aneksin V, Pjesa B, dhe ne rastet kur inspektori gjykon se duhet te meret moster perfaquesimi, kjo moster dergohet per analize ne laboratoret e specializuar

diagnostikues te references per t'u analizuar, kundrejt pageses prej zoteruesit te mallit.

- Bimet, produktet bimore dhe objektet e tjera te percaktuara ne Aneksin V, Pjesa B, kur importohen, duhet te jene te shoqeruara me Çertifikate Fitosanitare te leshuar prej autoritetit zyrtar fitosanitar te vendit te origjines.
- Kur bimet, produktet bimore dhe objektet e tjera bejne pjese ne Aneksin IV, Seksioni 1, Çertifikata Fitosanitare duhet te jetet e leshuar nga autoriteti zyrtar fitosanitar i vendit te origjines me perjashtim te:

- Drurit, i cili mund shoqerohet me Çertifikate Fitosanitare te leshuar nga autoriteti zyrtar fitosanitar i ndryshem nga vendi i origjines, ne qofte se sipas kerkesave te vecanta te parashikuara ne Aneksin IV, Seksioni 1, ai (druri) eshte perpunuar (zhveshur nga levorja) ne kete vend;
- Rasteve te tjera te vecanta te parashikuara ne Aneksin IV, Seksioni 1, kur ngarkesa shoqerohet me Çertifikate Fitosanitare te leshuar nga autoriteti zyrtar fitosanitar i ndryshem nga vendi i origjines.

REND.



Ne qofte se pjese nga nje ngarkese bimesh ose produktesh bimore eshte ndare, vene ne magazinim, ose i eshte nderruar ambalazhimi ne nje vend te ndryshem nga vendi i origjines, ajo duhet te shoqerohet nga nje Çertifikate Fitosanitare, e leshuar nga autoriteti zyrtar fitosanitar i vendit rieksportues, ose nga nje Çertifikate Fitosanitare Rieksporti, se bashku me Çertifikaten Fitosanitare te leshuar nga autoriteti zyrtar i vendit te origjines.

Gj. wha
m/ C. f.

Çertifikata Fitosanitare ose Çertifikata Fitosanitare e Rieksportit duhet te permbajne informacionin sipas modelit te Konventes Nderkombetare te Mbrojtjes se Bimeve, dhe duhet te jetet e leshuar prej autoritetit zyrtar te mbrojtjes se bimeve te vendit eksportues / rieksportues. Ne Çertifikate duhet te jetet modeluar dhe perdorur te pakten njera prej gjuheve zyrtare te Komunitetit European. emri botanik i bimes / bimeve duhet te jetet ne gjuhen latine.

Korigjimet apo ndryshimet e bejne te pa vlefshme nje Çertificate Fitosanitare. Originali dhe kopja e nje Çertificate Fitosanitare dallohen nga fjalet "Original" ose "Copy" ("Duplicate") te stampuara ne te.

REND.



Gjate shqyrtimit te Çertifikates Fitosanitare, eshte e rendesishme te kontrollohet vula. Çertifikata Fitosanitare duhet te jetet e vulosur yetem nga autoriteti i mbrojtjes se bimeve (inspektori i mbrojtjes se bimeve) i vendit ku eshte plotesuar ajo çertificate. Asnjë autoritet tjeter nuk ka te drejte ta vulose ate. Psh nje Çertifikate Fitosanitare nuk eshte e vlefshme nese ajo mban vulen e Drejtorese se Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit; ose te nje kompanie prodhuese ne rastin e importit; Çertifikata fitosanitare nuk mund te vuloset as nga çfardo zyre tjeter e Ministrise se Bujqesise te vendit te origjines se ngarkeses, perveç se nga vula e sherbimit te mbrojtjes se bimeve.

Nje perjashtim mund te jetet psh. Çertifikata fitosanitare per lenden e drurit te konifereve qe mund te vije nga Kanadaja ose SHBA. Ne kete rast certifikata e trajtimit me nxehësi duke përdorur një furrë dhe çertifikata e ç`voshkjes së lëvores zëvendësojnë çertifikatën fitosanitare. Çertifikata në fjalë është shkruar nga një

(REND.)
D

operator që ka ndjekur një kurs të mbrojtjes së bimëve të Shërbimit Fitosanitar të vendit eksportues. Ky do të jetë një subjekt specifik në inspektimet e drurit. Keto certificata mund te jene te pranueshme vetem atehere kur midis shtetit eksportues dhe atij importues ka një marreveshje e cila e parashikon edhe kete çeshtje.

Gjate kontrollit dokumentar, inspektori kontrollon daten e leshimit te Çertifikates Fitosanitare ose Çertifikates Fitosanitare te Rieksportit, te cilat duhet te jene leshuar nga vendi i origines apo vendit rieksportues jo me perpara se 14 dite nga momenti kur bimet, produkte bimore apo objektet e tjere i neneshtrohen inspektimit fitosanitar ne pikat kufitare te hyrjes.

3

Gjate kontrollit dokumentar, inspektori shqyrton edhe dokumenta te tjera shoqeruese. Në përgjithësi, vetëm çertifikata fitosanitare e origjinës nuk është e mjafitueshme për kryerjen e kontolleve, shih, psh. kontrollin brenda ditës së 14; dokumenta te dobishme janë pa dyshim, fatura e ngarkimit, ose fatura e shitjes dhe lista e ambalazhit, etj.

Manifesti i anijes

Ai nuk është një dokument shoqërues, por është e dobishme të dihet çfarë është ai. Mbi të gjitha egziston një manifest ngarkimi dhe një shkarkimi. Manifesti i ngarkimit është një dokument ku shkruhet çfarë ka në anije në momentin e ngarkimit. Manifesti i shkarkimit është ai dokument ku janë shënuar mallrat present në anije dhe që do të shkarkohen në port. Zakonisht, në anjet që bëjnë pikërisht një shkarkesë, të dy manifestet perputhen. Fatura e ngarkimit i bashkëngjitet manifestit të shkarkimit.

Fatura e ngarkimit

Fatura e ngarkimit është një dokument zyrtarisht i njohur në nivel ndërkombëtar, që vërteton ngarkimin e mallrave në anije dhe ku vendosen të dhëna identifikuuese për mallrat.

Duke krahasuar të dhënrat e kësaj fature me ato të çertifikatës fitosanitare të origjinës, është e mundur të kontrollohet korrespondimi midis të dy dokumentave dhe identiteti i mallrave.

Eshtë e nevojshme të bëhet kujdes nëse fatura është një faturë-kuadër, gjë që do të thotë se paraqet të dyja, etiketën dhe vulën e zyrës së manifestit të doganës, që provon praninë e mallrave në port. Siç mund të vihet re, ka dy tregues: A2, që është një shënim i bërë nga dogana për rregjistrat e saj, dhe A3, që është një shënim i plumbosjes së përkohëshme.

Fatura e shitjes

Eshtë një dokument që vërteton shitjen, dhe për pasoje mund të jetë e ndryshme nga fatura e ngarkimit; ajo mund të jetë e dobishme për të ditur cila është ngarkesa efektive e mallrave.

Kontroll Identitet
(2)
3
Kontroll Fito
(apr. Fit 110)

Liste e ambalazheve

Eshtë një listë e mallrave që përbledh kontainerët ku janë vendosur shumë artikuj. Ajo është e dobishme nëse në kontainer ka varietetë të ndryshme farërash.

Vonroll Identifikat
(2)
Pas kontrollit dokumentar kryhet kontrolli i identitetit. Mallrat duhet të janë të njëjtë në identitet dhe cilësi me atë çka deklarohet në certifikatën fitosanitare. Kjo kontrollohet thjesht duke vështruar mallrat dhe nëse është e nevojshme të kontrollohen dokumentat që disponohen.

Vonroll Identifikat
(3)
Ne vijim te inspektimit kryhet kontrolli fitosanitar, pra kontrolli fizik i ngarkesës me bime, produkte bimore ose objekte te tjera.

Vonroll Identifikat
(4)
Ne rastet kur ngarkesa perben bime, produkte bimore ose objekte te tjera që permenden ne Aneksin III dhe vijnë nga shtete te permendura ne kete aneks, si dhe janë percaktuar ne Aneksin V Pjesa B, ose nuk bajne pjese ne kete aneks por eshte e shoqeruar nga Çertifikata Fitosanitare dhe kur kjo ngarkese kalon tranzit neper territorin e Shqipërisë; atehere ajo (ngarkesa) lejohet te kaloje vetem nese nga inspektimi fitosanitar rezulton se ambalazhimi i tyre eshte bere ne kushte te tillë sigurie që garanton mosperhapjen e paraziteve karantinore.

Ka raste kur per bime, produkte bimore ose objekte te tjera te percaktuara ne Aneksin V, Pjesa B, ose te pa percaktuara ne Aneksin V, Pjesa B, por që pajisen me Certifikate Fitosanitare; Ministri, nepermjet marreveshjeve dypaleshe mund te kërkoje që inspektimet fitosanitare te kryhen ne shtetin eksportues ne bashkepunim me autoritetet fitosanitare te atij shteti.

Ne rastet kur bimet, produktet bimore ose objektet e tjera te percaktuara ne Aneksin V, Pjesa B, ose te pa percaktuara ne Aneksin V, Pjesa B, por te pajisura me Çertifikate Fitosanitare gjate inspektimit fitosanitar rezultojne te pa infektuar ose te pakontaminuar nga parazite te permendur ne Aneksin I dhe ne Aneksin II (kur bimet dhe produktet bimore bajne pjese ne Aneksin e II); dhe plotesojne kerkasat e veçanta te specifikuara ne Aneksin IV, Seksioni 1; lejohen te hyjne ne një Zone te Mbrojtur vetem atehere kur plotesohen kerkasat e veçante ne fuqi per kete Zone.

KERKESA TE VEÇANTA PER LENDEN DRUSORE TE PERDORUR SI AMBALAZH OSE NE PALETA

Regullore mbi masat fitosanitare për tregëtimin e ambalazhit prej druri
Standarti - ISPM 15:

 Rritja e qarkullimit botëror të mallrave, ka rritur rrezikun e përhapjes së parazitëve të vecantë të cilët mund ta zbulojnë vetvehten duke u perhapur gjérësisht.

REND

Druri që shoqëron mallrat, si ambalazh ose mbështetje, nuk është një përjashtim dhe shpesh është bartës i parazitëve (insekte, kërpudha dhe nematoda) që janë në gjëndje të vendosen në territorin ku ata arrijnë, janë në gjendje të dëmtojne pyjet dhe për pasojë janë një element i "rrezikut fitosanitar". Druri është një terren shumëzimi për insektet ksilofagë që mund të jetojnë atje në çdo stadh të zhvillimit të tyre.

Standarti ISPM Nr. 15 e publikuar nga FAO vndos rregullat mbi qarkullimin e Materialit Ambalazh prej Druri në Tregëtinë Ndërkombëtare.

Ka si objektiv identifikimin e procedurave dhe parimeve për strukturën që duhet krijuar për parandalimin e hyrjes dhe/ose përhapjes së parazitëve me ambalazhin prej druri. ISPM 15 mbulon subjekte të lidhura me krijimin e standardeve të ambalazhit prej druri dhe lejimit të përdorimit të shenjave që tregojnë që prodhuesi i ambalazhit prej druri është në pajtueshmëri me kërkasat e garantuara në lidhje me sigurinë fitosanitare, pas trajtimit me nxehësi ose me metoda të tjera, për të parandaluar transferimin dhe përhapjen e parazitëve në qarkullimin brënda vendit dhe në nivel internacional, të ambalazhit prej druri.

Kërkasat për ambalazhin prej druri të përdorur në produktet e importuara

Në përputhje me standartin ISPM 15, ambalazhi prej druri duhet të jetë:

- i qëruar nga lëvorja;
- i trajtuar me nxehësi ose me fumigim; i gjithë materiali drusor ambalazh prej druri duhet te trajtohet me nxehësi në të paktën 56°C (temperaturë të zemrës së drurit) për së paku 30 minuta. Qëllimi i këtij trajtimit është të eleminohen dëmtuesit dhe sëmundjet karantinore;
- i shënuar në pajtim me standartin ISPM 15.

Praktikisht, gjate inspektimit fitosanitar fizik te bimeve, produkteve bimore dhe objekteve te tjera; vemendje e vecante i kushtohet ambalazhit (me spesor mbi 6 mm) prej druri, materialeve mbështetese prej druri, paletave etj. Ne keto ambalazhe duhet te jene te vulosura ne dru (jo fletushka prej letre te ngjitura), ne pjeset ballore te dukshme, te dhena mbi dezinfektimin sipas standartit ISPM 15. Sipas ketij standarti, ne anen e majte brenda kuadratit te kesaj vule qendron emblema e Organizates Boterore te Ushqimit FAO. Ne anen e djathte ne dy rrjeshta duhet te jene shkruar: Ne rrjeshtin siper, kodi i vendit (psh. Al, IT, GR etj) ku eshte rregjistruar kompania qe ka kryer dezinfektimin.

Pastaj eshte shkruar kodi I i kesaj kompanie. Ne rrjeshtin poshte duhet te jete shkruar menyra e dezinfektit:

- HT – Trajtim me nxehesi ose,
- Fumigim

Materiali që nuk plotëson këto kërkesa, shkatërrohet me shpenzimet e importuesit, ose është subjekt fumigimi ose trajtimi me nxehësi, ose rikthehet nga ka ardhur.

Veprime ne perfundim te inspektimit

Kur bimet, produktet bimore ose objektet e tjera te percaktuara ne Aneksin V, Pjesa B, ose te pa percaktuara ne Aneksin V, Pjesa B, por te pajisura me Çertifikate Fitosanitare gjate inspektimit fitosanitar rezultojne te infektuara ose te kontaminuara nga parazite te permendur ne Aneksin I dhe ne Aneksin II (kur bimet dhe produktet bimore bejne pjesë ne Aneksin e II); dhe nuk plotesojne kerkesat e vecanta te specifikuara ne Aneksin IV, Seksioni 1; atehere inspektori fitosanitar urdheron marrjen e ketyre masave:

- Behet trajtimi fitosanitar me metoda te cilat garantojnë dezinfektimin e ngarkesës.
- Veçohen pjeset e infektuara apo te kontaminuara te ngarkesës nga pjeset e pastra dhe asgjesohen me metoda te cilat garantojnë shkaterrimin e plete te parazitit dhe pamundesine e tij per t'u perhapur ne territorin e Shqipërise.
- Dergimin e një mostre perfaqesuese per analiza diagnostike fitosanitare. Deri ne daljen e rezultateve te analizave **zyrtare laboratorike** ngarkesa vendoset ne rregjim karantinor. Kur lloji i ngarkesës dhe parazitit te konstatuar janë te tillë që me anë te perpunimit industrial garantohet shkaterrimi i plete i parazitit dhe pamundesia e perhapjes se tij ne territorin e vendit, atehere lejohet transportimi i ngarkesës nen kontrollin e inspektoreve deri ne vendin e perpunimit ku dhe egzekutohet perpunimi i urdheruar.
- Kthimin e ngarkesës ne vendin e origjines, nga ka ardhur.
- Asgjesimin e ngarkesës me metoda te cilat garantojnë shkaterrimin e plete te parazitit dhe pa mundesine e perhapjes se tij ne territorin e vendit.

Zotueresi i ngarkesës perballon te gjitha shpenzimet financiare që lidhen me masat e siperpermendura, te urdheruara nga inspektori fitosanitar.

Kur importuesi i ngarkesës refuzon marrjen e ketyre masave fitosanitare, atehere inspektori fitosanitar vendos ne Çertifikaten Fiotosanitare **vulen** trekendore me ngjyre te kuqe me mbishkrinin "Çertificate Cancelled" me emrin e Inspektorit dhe daten e refuzimit.

Ne perfundim te inspektimit te ngarkesës me bime, produkte bimore ose objekte e tjera te percaktuara ne Aneksin V, Pjesa B, ose te pa percaktuara ne Aneksin V, Pjesa B, por te pajisura me Çertifikate Fitosanitare, dhe kur ngarkesa lejohet te hyje ne territorin e vendit; inspektori fitosanitar i pikes kufitare te hyrjes ploteson nje raport mbi rezultatin e inspektimit fitosanitar te ngarkesës sipas modelit te miratuar ne fuqi (Rregulla te inspektimit karantinor fitosanitar), i cili i paraqitet autoriteteteve doganore te asaj pike kufitare.

Me poshte pershkruhen disa raste te cilat hasen gjate kontrollit dokumentar, kontrollit te identitetit dhe kontrollit fizik fitosanitar

PERCAKTI I RREZIKUT FITOSANITAR NE NJE NGARKESE
 (tabele vendim marrjeje)

	<i>Ngarkesa eshte e perbere nga bime, produkte bimore ose objekte te tjera te disa llojeve qe vijne nga zona gjeografike te ndryshme</i>	Shih
		<i>Po</i> <i>Jo</i>
		1 2
1	<i>Egzamino cdo pjese / lot veçmas</i>	3
2	<i>Egzamino ngarkesen te pakten nje lot</i>	3
3	<i>Organizma karantinore te njohur qe jane present ne vendin eksportues</i>	5 4
4	<i>Organizma karantinore dihen qe jane present ne nje rrajon ekologjik te vendit eksportues</i>	5 7
5	<i>Tregeti dhe perberje e loteve e rregullt dhe me madhesi te rregullt</i>	7 6
6	<i>Tregeti / tregetar i rastit ose i ri .</i>	RL 9
7	<i>Zbulime te tjera te mepareshme te bera mbi ngarkesa te tjera te te njejtit tip ose nga l njeji burim</i>	9 8
8	<i>Informacion i veçante mbi metodat e inspektimit dhe trajtimet e ndermarra ne vendin eksportues</i>	RU RM
9	<i>Sezoni i importimit ose vendi i prodhimit te kultures (sere ose fidanishte) kane favorizuar vendosjen e organizmave karantinore</i>	RL RM

RU – Rrezik i ulet

RM – Rrezik i mesem

RL – Rrezik i larte

PROBLEME DHE VEPRIME QE NDERMERREN

	Nr	Problemi / Pergjigje	Veprimi
Kontrolli Dokumentar	0	A jane sherbimet e interesuara qe kryejne inspektimet e importeve, te njoftuara ne kohe te mjaftueshme perpara hyrjes se nje ngarkese qe ka mundesi te paraqese nje rrezik fitosanitar nepermjet importimi?	X Po X Jo
	1	A pershkruajne dokumentat pranine e bimeve, produkteve bimore ose objekteve te tjera ne ngarkese?	
	1	Kontrollo ne dokumentat qe shoqerojne ngarkesen nese ato bejne fiale per pranine e bimeve, produkteve bimore e objekteve te tjera.	X Po X Jo
	2	A permban kjo ngarkese bime, produkte bimore dhe objekte te tjera te listuar ne Aneksin III Verifiko nese keto bime, produkte bimore dhe objekte te tjera bejne pjese ne: Aneksin III A Aneksin III B (ne kete rast kontrollo destinacionin e ngarkeses)	X Po X Jo
	3	A ka ndonje marreveshje teknike te bere me vendet e origjines?	X Po X Jo
	4	A jane bimet, produktet bimore dhe objektet e tjera te importuara "te perjashtuara" ne lidhje me kerkesat e Aneksit III Verifiko, nese bimet, produktet bimore dhe objektet e tjera jane importuar me kushtin "te perjashtuara" (shih listen ne Vendimin e perjashtimeve).	X Po X Jo

	5	A permbushin bimet, produktet bimore dhe objektet e tjera konditat e Vendimit "te perjashtimit". Kontrollo, nese kushtet e percaktuara ne vendim (perfshi deklarimet shtese, pikat e hyrjes etj) jane permbushur.	<input checked="" type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	14 Plotesohet nje certificate njoftimi qe paraqet problemin e zbuluar dhe masen e marre.
	6	A jane bimet, produktet bimore dhe objektet e tjera te shoqeruara me nje certificate fitosanitare?	<input checked="" type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	9 7
	7	A jane bimet, produktet bimore dhe objektet e tjera te importuara nen statusin "te perjashtuara", duke lejuar importimin pa certificate fitosanitare? Verifiko, nese bimet, produktet bimore dhe objektet e tjera jane importuar me kushtin "te perjashtuara" (shih listen ne Vendimin e perjashtimeve).	<input checked="" type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	8 Plotesohet nje certificate njoftimi qe paraqet problemin e zbuluar dhe masen e marre.
	8	A permbushin bimet, produktet bimore dhe objektet e tjera konditat e Vendimit "te perjashtimit". Kontrollo, nese kushtet e percaktuara ne vendim (perfshi deklarimet shtese, pikat e hyrjes etj) jane permbushur.	<input checked="" type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	11 Plotesohet nje certifikate njoftimi qe paraqet problemin e zbuluar dhe masen e marre.
	9	A jane certifikatat fitosanitare te plotesuara ne rregulli? Kontrollo ne vecanti: Firmen ne Çertifikaten fitosanitare; ✓ Lexueshmerine e Certificates fitosanitare ✓ Periudhen e vlefshmerise (dhe vulat e fiksuara maksimumi 14 dite para dates ne te cilen bimet, produktet bimore dhe objektet e tjera lene vendin eksportues)	<input checked="" type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	10 Plotesohet nje certifikate njoftimi qe paraqet problemin e zbuluar dhe masen e marre.
	10	A jane bimet, produktet bimore dhe objektet e tjera te importuara nden statusin "te perjashtuara" te ndryshme nga ato te permendura tashme me lart? Kontrollo nese bimet, produktet bimore dhe objektet e tjera jane importuar nden statusin "te perjashtuara" (shih listen e rifreskuar te Vendimit mbi perjashtimet)	<input checked="" type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	11 12

		A permbushin bimet, produktet bimore dhe objektet e tjera kushtet e percaktuara ne Vendimin e perjashtimit? Kontrollo, nese kushtet e percaktuara ne vendim (perfshi deklarimet shtese, pikat e hyrjes etj) jane permbushur.	Po Jo	14 Plotesohet nje çertifikate njoftimi qe paraqet problemin e zbuluar dhe masen e marre.
	12	PER ÇDO TIP BIME, PRODUKTI BIMOR DHE OBJEKT TJETER NE NGARKESE, A eshte origjina e importit te ketyre bimeve, produkti bimor dhe objekte te tjera e ndaluar? Kontrollo, nese kjo bime, product bimor dhe objekt tjeter eshte listuar ne Aneksin III A, ne kete rast kontrollo identitetin dhe origjinjen e bimes, produktit bimor dhe objektit tjeter ne Çertifikaten fitosanitare. Aneksi III B, ne kete rast kontrollo identitetin, origjinjen dhe destinacionin bimes, produktit bimor dhe objektit tjeter ne Çertifikaten fitosanitare.	Po Jo	Plotesohet nje çertifikate njoftimi qe paraqet problemin e zbuluar dhe masen e marre.
	13	A eshte kjo pike e kalimit kufitar e autorizuar per hyrjen e kesaj bime, produkti bimor apo objekti tjeter? Kontrollo nese kjo pike hyrjeje eshte ne listen e pikave te hyrjes te lejuara per ketelloj ngarkese.	Po Jo	13 Plotesohet nje çertifikate njoftimi qe paraqet problemin e zbuluar dhe masen e marre.
Kontrolli Identitetit	14	A eshte kjo ngarkese me bime, produkte bimore ose objekte te tjera ne perputhje me identitetin e deklaruar ne dokumentat shoqeruese? Kontrollo identitetin fizik te ngarkeses me bime, produkte bimore ose objekte te tjera.	Po Jo	15 Plotesohet nje çertifikate njoftimi qe paraqet problemin e zbuluar dhe masen e marre.
Kontrolli Fitosanitar Fizik	15	A eshte ngarkesa me bime, produkte bimore apo objekte te tjera, subject i kerkesave te vecanta, -Kontrollo nese bimet, produktet bimore ose objektet e tjera jane listuar ne: Aneksin IV, A, I Aneksin IV, B (ne kete rast kontrollo destinacionin e bimeve, produkteve bimore apo objekteve te tjera).	Po Jo	16 17

	<p>16 A jane plotesuar kerkesat e veçanta? Kontrollo bimet, produktet bimore ose objektet e tjera (kur eshte e mundur), nese jane plotesuar kerkesat e veçanta (me ndihmen e mundeshme te procedurave specifike).</p> <p>Po Jo</p>	<p>17 Plotesohet nje çertifikate njoftimi qe paraqet problemin e zbuluar dhe masen e marre.</p>
	<p>17 A jane bimet, produktet bimore ose objektet e tjera strehuese per treguesit qe permaban ne Aneksin II? - Kontrollo, nese bimet, produktet bimore ose objektet e tjera jane te listuara ne : Aneksin II, A, I Aneksin II, B (ne kete rast kontrollo destinacionin e bimeve, produkteve bimore ose objekteve te tjera).</p> <p>Po Jo</p>	<p>18 19</p>
	<p>18 A jane bimet, produktet bimore ose objektet e tjera te kontaminuara me organizem/ma karantinore te permendura per to ne Aneksin II? Kontrollo nese bimet, produktet bimore ose objektet e tjera jane te kontaminuara me organizem/ma karantinore te permendura per to ne Aneksin II.</p> <p>Po Jo</p>	<p>Plotesohet nje çertifikate njoftimi qe paraqet problemin e zbuluar dhe masen e marre. 19</p>
	<p>19 A jane bimet, produktet bimore ose objektet e tjera te kontaminuara nga organizem/ma karantinore te listuara ne Aneksin I? - Kontrollo nese bimet, produktet bimore ose objektet e tjera jane te kontaminuara nga organizem/ma karantinore te listuara ne: Aneksin I A Aneksin I B (ne kete rast kontrollo destinacionin e ngarkese).</p> <p>Po Jo</p>	<p>Plotesohet nje çertifikate njoftimi qe paraqet problemin e zbuluar dhe masen e marre. 20</p>
Kontrolli Fitosanitar Fizik	<p>20 A duhet qe keto bime, produkte bimore ose objekte te tjera te jene te shoqeruara me nje pasaporte bimesh, me qellim qe te levizin lirisht brenda Bashkimit European / per ne Shqiperi? - Kontrollo nese bimet, produktet bimore ose objektet e tjera jane listuar ne: Aneksin V A I Aneksin V A II (ne kete rast kontrollo destinacionin e bimeve, produkteve bimore ose objekteve te tjera).</p> <p>Po Jo</p>	<p>Pajisja me nje pasaporte bimesh per cdo bime, product bimore ose object tjeter perkatesisht OK</p>

	<p><i>A jane bimet, produktet bimore ose objektet e tjera te kontaminuara nga organizem/ma karantinore te listuara ne Aneksin I?</i></p> <p><i>- Kontrollo nese bimet, produktet bimore ose objektet e tjera jane te kontaminuara nga organizem/ma karantinore te listuara ne:</i></p> <p><i>Aneksin I A</i></p> <p><i>Aneksin I B (ne kete rast kontrollo destinacionin e ngarkese).</i></p>	<p><i>Plotesohet nje çertifikate njoftimi qe paraqet problemin e zbuluar dhe masen e marre.</i></p> <p>Po</p> <p>Jo</p>
--	---	---

OK – Ngarkesa lejohet te kaloje

Ne Sherbimin Qendror dhe ne Sherbimet Rajonale te Mbrojtjes se Bimeve ne vendet anetare te Bashkimit European egziston nje rregjister ku jane te rregjiistruar te gjithe prodhuesit dhe tregetuesit (importues dhe eksportues) e bimeve, produkteve bimore dhe objekteve te tjera qe lidhen me bimet. Seicili nga te rregjistruarit disponon nje numer rregjistrimi.

✓ Kap. V pilu 1 (VKM.750 d.d. 14/7/2010)

Per analogji, ne vandin tone, çdo person fizik dhe juridik qe merret me importimin, prodhimin, grumbullimin dhe shitjen me shumice te bimeve, produkteve bimore dhe objekteve te tjera, te permendura ne Aneksin V, Pjesa A dhe B; ndaj te cileve kerkohet te kryhen inspektive fitosanitar, **duhet te registrohet** ne Drejtorine e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit (DBUMK) te qarkut (Sektorin e Mbrojtjes se Bimeve) ku ata zhvillojne aktivitetin e tyre. Ata, pasi plotesojne formularin perkates te rregjistrimit, paisen me nje numer identifikimi.

Duhet te registrohen ata persona qe kryejne keto aktivitete:

- Prodhim dhe ruajtje ne fidanishte ose magazina te bimeve ose pjese bimesh te destinuara per shumezim ose mbjellje.
- Importimin e bimeve, produkteve bimore dhe objekteve te tjera te percaktuara ne Aneksin V, Pjesa B.
- Eksportimin, ri-eksportimin e bimeve, produkteve bimore dhe objekteve te tjera te percaktuara ne Aneksin V, Pjesa A dhe B.
- Shitjen me shumice e bimeve apo pjeseve bimore te destinuara per shumezim dhe mbjellje.
- Qendra te grumbullimit dhe ato te shitjes me shumice te bimeve apo produkteve bimore.

Regjistrimi dhe inspektimi fitosanitar mund te kerkohet nga Ministri edhe per ata persona qe trajtojne bime, produkte bimore dhe objekte te tjera te cilat nuk permenden ne Aneksin V, Pjesa A dhe B.

Nuk jane te detyruar te rregistrohen sipas rregullave te mesiperme, ata prodhues apo perpunues te vegjel, kur gjykohet se ata nuk paraqesin ndonje rrezik per shumezimin dhe perhapjen e paraziteve te permendor ne Aneksin I dhe II, dhe, kur bimet, produktet bimore dhe objektet e tjera qe trajtohen me kete Manual jane te

destinuara per konsum vetjak dhe prodhohen apo perpunohen prej personave te cilet nuk jane profesionalisht te angazhuar me prodhimin e madh bimor.

Personat e regjistruar duhet te informojne me shkrim DBUMK kur:

- nderpresin aktivitetin per te cilin jane regjistruar
